

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM EKONOMIK (OECD), PËR BËRJEN PALË NË KUADRIN GJITHËPËRFSHIRËS TË PROJEKTIT NDËRKOMBËTAR MBI EROZIONIN E BAZËS SË TATUESHME DHE TRANSFERIMIN E FITIMIT (BEPS)”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Duke qenë se ambienti i taksimit ndërkombëtar ka ndryshuar në mënyrë thelbësore vitet e fundit, si rezultat i krizës financiare dhe planifikimit agresiv tatimor nga ana e shoqërive shumëkombëshe, me suportin politik të liderëve të G20, komuniteti ndërkombëtar mori masa për të adresuar dobësitë e sistemit ndërkombëtar të taksimit, që krijojnë mundësi për erozion të bazës së taksueshme dhe transferim të fitimeve (*BEPS-Base Erosion Profit Shifting*).

Për këtë arsye, në shtator 2013, liderët e G20 miratuan projektin ndërkombëtar dhe gjithëpërfshirës të BEPS-së, i cili, i zhvilluar së bashku me anëtarët e OECD-së, ka si synim arritjen e tre objektivave kryesorë:

1. Përforsim të koherencës së rregullave të tatimit mbi të ardhurat e korporatave në nivel ndërkombëtar;
2. Lidhjen e tatimit me përmbajtjen e aktiviteteve ekonomike të realizuara;
3. Përmirësim të transparencës.

Në vijim, në përgjigje të kërkesës së liderëve të G20, OECD-ja zhvilloi një kuadër gjithëpërfshirës të BEPS (*Inclusive Framework on BEPS*), i cili i lejon dhe u jep mundësinë dhe vendeve që janë në zhvillim (jo vetëm atyre të zhvilluara) të punojnë në mënyrë të barabartë me anëtarët e OECD-së dhe G20 në zhvillimin e standardeve mbi çështjet që lidhen me BEPS-në si dhe rishikimin dhe monitorimin e implementimit të të gjithë paketës BEPS.

Në maj të vitit 2016 Shqipëria mori ftesë nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) për t’iu bashkuar kuadrit gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e

bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit. Ftesa e mësipërme u përsërit në datën 27 mars 2018.

Me propozimin e këtij projektligji pranohet ftesa e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, me qëllim bërjen pjesë të Republikës së Shqipërisë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar BEPS. Kjo, dhe në përmbushje të angazhimit të Shqipërisë ndaj Komisionit Evropian, se vendi ynë do të jetë pjesë e kuadrit gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar BEPS në vitin 2019. Pjesëmarrja në këtë projekt është plotësim i kriterit thelbësor që Shqipëria të mos jetë në listën e vendeve të kategorizuara si jo bashkëpunuese nga Komisioni Evropian në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet e taksave.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Pjesëmarrja në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit i jep mundësinë vendeve anëtare të punojnë në mënyrë të barabartë në trajtimin e shmangies tatimore, të përmirësojnë koherencën e rregullave të marrëveshjeve tatimore dhe të sigurojnë një ambient tatimor sa më transparent. Në veçanti për të gjitha vendet pjesëmarrëse ky projekt ofron:

- zhvillimin e standardeve në lidhje me çështjet e BEPS-së;
- rishikimin dhe implementimin e standardeve minimale nëpërmjet një sistemi efektiv monitorimi;
- një forum për vendet që të nxjerrin në pah sfidat në zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe të gjejnë zgjidhje të reja, kjo është veçanërisht e rëndësishme për vendet në zhvillim;
- lehtësimin e procesit të implementimit duke ofruar orientim të mëtijshëm dhe suport për vendet në zhvillim, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve dhe drejtimin sipas platformës së bashkëpunimit për tatimet, e ngritur kjo nga organizatat ndërkombëtare (IMF, OECD, UN dhe WB).

Duke qenë pjesë e kuadrit gjithpërfshirës të projektit ndërkombëtar BEPS, vendet anëtare marrin angazhimin për sa i përket plotësimit të standardeve minimale të paketës BEPS, e cila në total përmbledh 15 plane veprimi. Kjo paketë i pajis shtetet pjesëmarrëse me instrumente vendase dhe ndërkombëtare për të adresuar shmangien e taksave, në mënyrë që fitimet të tatohen aty ku kryhen aktivitetet ekonomike që i gjenerojnë ato dhe aty ku krijohet vlera. Aktualisht janë 113 juridiksione anëtare të kuadrit gjithpërfshirës të projektit ndërkombëtar BEPS.

Pra, në përgjithësi vendet jo OECD / jo G20 (siç është dhe rasti i vendit tonë) mund të përfitojnë nga puna e përfshirë në “paketën BEPS” në përpjekjet e tyre për të luftuar shmangien e tatimeve. Në zbatimin e masave të BEPS, ato gjithashtu mund të marrin mbështetje të koordinuar dhe më të orientuar për ndërtimin e kapaciteteve në zbatimin e rezultateve të BEPS-së nga organizatat ndërkombëtare dhe rajonale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në harmoni me Kushtetutën dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen palë në kuadrin gjithpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS), është miratuar, në parim, me vendimin nr.628, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin e ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 3 nene.

Neni 1 parashikon ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen pjesë të Republikës së Shqipërisë në kuadrin gjithpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe shmangien e fitimit (BEPS).

Neni 2 parashikon se për bërjen palë të Republikës së Shqipërisë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe shmangien e fitimit (BEPS), do të paguhet një kuotë anëtarësie prej 20 200 eurosh në vit, vlerë e cila do të rregullohet dhe me inflacionin vjetor përkatës nga ana e OECD-së.

Neni 3 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Si dokument shoqërues i këtij projektligji paraqitet plani i veprimit për erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimeve (BEPS), i cili nuk është objekt i ratifikimit nga Kuvendi, pasi Shqipëria nuk është e detyruar të plotësojë të gjitha masat e këtij plani veprimi, por vetëm standardet minimale të tij, sipas përcaktimeve të OECD-së. Gjithsesi, sipas mundësive që ka shteti shqiptar mund të avancojë dhe më shumë se sa plotësimi i standardeve minimale.

Plani i veprimit BEPS, në mënyrë të përmbledhur, paraqitet, si më poshtë vijon:

Masa 1 – Adreson sfidën tatimore të ekonomisë digjitale.

Kjo masë konkludon se ekonomia digjitale nuk mund të jetë një unazë e mbyllur siç është ekonomia në vetvete. Raporti analizon riskun e BEPS-së të përkeqësuar në ekonominë digjitale dhe tregon impaktin e pritur nga masat që zhvillon projekti BEPS.

Rregullat dhe implementimi i mekanizmave janë zhvilluar për të ndihmuar mbledhjen e TVSH-së bazuar në vendin ku konsumatori është vendosur në rastin e transaksioneve *cross-border* nga biznesi te konsumatori. Këto masa kanë qëllim të lehtësojnë fushën e veprimit midis furnizuesve vendas dhe të huaj, si dhe mbledhjen me efikasitet të TVSH-së ndërmjet këtyre transaksioneve.

Duke qenë se sfidat dhe mundësitë e mundshme ngrenë çështje sistematike në lidhje me kuadrin ekzistues për tatimin e aktiviteteve ndërkufitare që shkojnë përtej çështjeve BEPS, OECD dhe vendet e G20 kanë rënë dakord për të monitoruar zhvillimet dhe analizuar të dhënat që do të jenë në dispozicion me kalimin e kohës.

Në bazë të monitorimeve të ardhshme do të përcaktohet nëse duhet punuar më tej mbi opsionet e diskutuara dhe analizat e kryera.

Masa 2 – Neutralizimi i efektit të mospërputhjes së marrëveshjeve hibride.

Një qasje e përbashkët e cila do të lehtësojë konvergjencën e praktikave ndërkombëtare me anë të rregullave të brendshme dhe të traktateve për të neutralizuar marrëveshje të tilla.

Kjo do të ndihmojë për të parandaluar taksimin 0, duke eliminuar përfitimet tatimore nga mospërputhjet, si dhe për t'u dhënë fund zbritjeve të shumëfishta për një shpenzim të vetëm, pra zbritjeve në një vend pa patur taksim në një tjetër, si dhe gjenerimit të kreditimeve të huaja tatimore të shumëfishta për një shumë tatimi të huaj të paguar.

Duke neutralizuar mospërputhjen në rezultatet tatimore, rregullat do të pengojnë përdorimin e këtyre marrëveshjeve si një mjet për BEPS-në pa ndikuar negativisht në tregtinë ndërkufitare dhe investimet.

Masa 3 – Forcimi i rregullave CFC.

Raporti nxjerr rekomandime në formën e rregullave për shoqëritë e kontrolluara nga shoqëri të huaja [*Controlled Foreign Company* (CFC)], duke mbajtur parasysh që objektivat politike ndryshojnë midis juridiksioneve. Rekomandimet nuk mund të merren si standarde minimale, por janë të projektuara në rastet kur një juridiksion zgjedh të implementojë këto rregulla, të cilat janë një mjet i mirë për të parandaluar transferimin e bazës së tatueshme jashtë territorit të saj. Raporti identifikon sfidat për rregullat e CFC në lidhje me të ardhurat lëvizëse nga pronësia intelektuale, shërbimet pa prezencë fizike dhe transaksionet digjitale dhe lejon juridiksionet të reflektojnë mbi vendimet e përshtatshme për t'u marrë në këto raste. Zhvillimet në vijim nxjerrin në pah faktin që rregullat e CFC kanë një rol të vazhdueshëm në gjurmimin e BEPS-së, si një pararojë për rregullat e transferimit të çmimit dhe të tjera.

Masa 4 – Kufizimi i erozionit të bazës së tatueshme nëpërmjet interesit të zbritshëm dhe pagesave të tjera financiare.

Një përjasje e përbashkët për të lehtësuar konvergjencën e rregullave të brendshme në fushën e zbritjes së tatimeve. Ndikimi i rregullave tatimore në lokalizimin e borxhit brenda shoqërive shumëkombëshe është përforcuar nga një sërë studimesh akademike dhe është e njohur që grupet e shoqërive shumëkombëshe, mundet lehtësisht të shumëfishojnë nivelin e borxhit nëpërmjet financimit brenda grupit. Përjasja më e zakonshme synon të sigurojë që zbritja e interesit neto të shoqërisë lidhet direkt me të ardhurat e tatueshme që rrjedhin nga aktiviteti i saj ekonomik dhe nxisin rritjen e koordinimit të rregullave të brendshme.

Masa 5 – Kundërshtimi i praktikave të dëmshme tatimore në mënyrë më efikase, duke marrë në konsideratë transparencën dhe thelbin/përmbajtjen.

Parandalimi i praktikave të dëmshme tatimore, duke marrë parasysh transparencën dhe thelbin e veprimit, është mbi të gjitha një regjim preferencial, i cili mund të përdoret kundër transferimit artificial të fitimit, sidomos kur ka mungesë transparence në lidhje me disa rregulla të përcaktuara.

Raporti mbi masën e pestë përcakton një standard minimal të bazuar mbi metodologjitë e rena dakord për vlerësimin e një aktiviteti thelbësor në një regjim preferencial. Parimi që mund të aplikohet për këto regjime është se për të funksionuar kërkojnë që aktivitetet thelbësore dhe reale të kryhen aty ku garantohet një përfitim në lidhje me tatimpaguesin. Në lidhje me transparencën është përmbyllur një kuadër paraprak rregullash për sa i përket detyrimit për shkëmbimin spontan të informacionit, mungesa e të cilit mund të sjellë krijimin e BEPS-së.

Masa 6 – Parandalimi i rasteve të abuzimit me marrëveshjet tatimore.

Kjo masë përfshin një standard minimal për parandalimin e rasteve të abuzimit duke përfshirë rastet e *treaty shopping* (Pazar me marrëveshjet) dhe rregulla të reja mbrojtëse për të parandaluar abuzimet me marrëveshjet e tatimit të dyfishtë. Ofron, gjithashtu, një shkallë të konsiderueshme fleksibiliteti në lidhje me mënyrën e të vepruarit. Rregullat e reja të përfshira në këtë raport, si fillim adresojnë problemet me *treaty shopping*, duke përfshirë strategji nëpërmjet të cilave një person jorezident tenton të përfitojë nga një marrëveshje. Gjithashtu, është dakordësuar ndryshimi i modelit të marrëveshjes së shmangies së tatimit të dyfishtë të OECD-së, që marrëveshjet të mund të përfshijnë rregulla kundër abuzimeve. Gjithashtu, raporti përfshin edhe masat e konsideratat që duhet të ketë parasysh vendimmarrja politike kur hyn në marrëveshje me vende me norma shumë të ulëta tatimi.

Masa 7 – Parandalimi i shmangies artificiale të Selisë së Përhershme.

Marrëveshjet e tatimit të dyfishtë parashikojnë që të ardhurat nga veprimtaria ekonomike e një biznesi të tatohen në një vend deri në masën që këto të ardhura krijohen nga një seli e përhershme aty. Përkufizimi i “Selisë së Përhershme” në një marrëveshje është kryesor për të përcaktuar nëse një jorezident që kryen aktivitet biznesi në një vend, duhet tatuar apo jo aty. Raporti përfshin ndryshime në përkufizim të nenit 5 të modelit të marrëveshjes së OECD-së, i cili përdoret gjerësisht në marrëveshjet midis vendeve. Këto ndryshime synojnë teknika të përdorura për të shmangur abuzimet, që mund të ndodhin si rezultat p.sh. i

zëvendësimin të rrjetit të distributorëve me marrëveshje komisionere, ose me fragmentim artificial të aktiviteteve të biznesit.

Masat 8 – 10 – Sigurimi që rezultati i transferimit të çmimit është në përputhje me krijimin e vlerave.

Sigurimi që rezultati i transferimit të çmimit është në përputhje me krijimin e vlerave dhe rregullat e transferimit të çmimit, siç përcaktohet në nenin 9, të modelit të marrëveshjes së OECD-së dhe të UN-së, si dhe në komentarin mbi transferimin e çmimit. Këto rregulla duhet të përdoren me qëllim që të arrihet parimi i vlerës së tregut (*arm's length*), duke përfshirë kushtet, çmimet, për transaksionet brenda grupit. Standardet ekzistuese në këtë fushë janë sqaruar më mirë, përfshirë udhëzuesin mbi parimin e vlerës së tregut dhe qasjen për të siguruar vlerësimin e saktë të transaksioneve të aktiveve të paprekshme, sipas parimit të vlerës së tregut. Puna u përqendrua në tre pika kryesore. Masa 8 përqendrohet në çështjet e transferimit të çmimit në lidhje me transaksionet e kontrolluara, duke përfshirë aktivet e paprekshme, pasi ka raste që është mjaft e vështirë për t'i përcaktuar vlerën reale. Keq alokimi i fitimit të siguruar nga vlera e tyre ka kontribuar në rritjen e problemeve të BEPS-së. Sipas masës 9, alokimet e risqeve të rëna dakord me marrëveshje respektohen vetëm nëse janë të ndërmarra nga vendimmarrje të qenësishme, duke i pasur nën kontroll këto risqe. Masa 10 përqendrohet në fusha të tjera me risk të lartë, duke përfshirë qëllimin e adresimit të alokimit të fitimit që rezulton nga transaksionet e kontrolluara të cilat nuk paraqesin baza racionale, me qëllim përdorimin e rregullave të transferimit të çmimit në një mënyrë që synon shtrembërim të fitimit dhe transferimin e tij drejt pikave të kontrolluara nga shoqëritë shumëkombëshe. Raporti bën të mundur krijimin e rregullave dhe të udhëzuesve që ndihmojnë në lidhjen e fitimit operativ me veprimtarinë ekonomike që e krijon atë. Raporti, gjithashtu, përmban udhëzues mbi vlerësimin e transaksioneve ndërkufitare të të mirave dhe shërbimeve që sjellin shtim ose krijim të vlerës. Këto dy fusha janë shumë të rëndësishme për vendet në zhvillim dhe, për këtë arsye, do të ketë shumë punë në vijim, me qëllim krijimin e njohurive të mjaftueshme, rastet dhe përvojat më të mira, dhe të mekanizmave që duhet të ndërmarrin këto vende, për qëllime të transferimit të çmimit.

Masa 11 – Matja dhe monitorimi i BEPS-së.

Ekzistojnë qindra studime empirike që vërtetojnë gjetjet për transferimin e fitimit, duke përdorur më së shumti të dhëna të ndryshme dhe strategji vlerësimi. Ndërkohë që është sfiduese të masësh qëllimin e BEPS-së për arsye të kufizimit të të dhënave. Një numër studimesh së fundmi arsyetojnë që humbjet e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin si pasojë e BEPS-së janë shumë të mëdha. Masa 11 vlerëson të dhënat aktuale dhe metodologjitë për përdorimin e tyre për të vlerësuar

shkallën e impaktit ekonomik të BEPS-së. Duke parë këto kufizime në të dhëna është krijuar një tabelë me 6 tregues për BEPS-së. Këta tregues sigurojnë sinjale të forta për ekzistencën e BEPS-së dhe efekti i tyre është rritur vazhdimisht me kalimin e kohës. Gjithashtu, kanë dalë në pah edhe disa shtrebmërimë ekonomike jofiskale të shkaktuara nga BEPS-ja, dhe për këtë janë propozuar rekomandime. Në vijim, rritja e analizës ekonomike dhe e monitorimit të BEPS-së do të kërkojë nga vendet e angazhuara të përmirësojnë mbledhjen, përpilimin dhe analizën e të dhënave shtesë.

Masa 12 – Tatimpaguesve u kërkohet të informojnë mbi rregullimet agresive të planifikimit tatimor.

Mungesa e informacionit në luftën kundër rregullimeve agresive është një nga sfidat e administratave tatimore në të gjithë botën. Aksesit në kohë i këtij informacioni siguron mundësinë për t’iu përgjigjur shpejt këtyre risqeve, nëpërmjet vlerësimit të riskut, kontrolleve tatimore, por edhe mundësive për ndryshime në ligj.

Raporti për masën 12 siguron një kuadër të plotë të ndërtuar sipas praktikave më të mira të përdorura nga vendet që nuk kanë rregulla për deklarim të detyrueshëm. Rekomandimet në këtë raport nuk përbëjnë një standard minimal më vete dhe vendet janë të lira nëse duan t’i përfshijnë këto rregulla ose jo. Kuadri është referencë edhe për vendet që kanë detyrimin për deklarim të detyrueshëm të këtyre rregullimeve, me qëllim rritje të efektivitetit. Rekomandimet parashikojnë fleksibilitetin e duhur për të baraspeshuar nevojat e një vendi për informacione cilësore dhe brenda një kohe të shkurtër. Gjithashtu, përcakton rekomandime për praktikën më të mira dhe rregulla për shënjestrimin e skemave ndërkombëtare të taksimit, si dhe për zhvillimin e implementimin e shkëmbimit të informacionit midis administratave tatimore.

Masa 13 – Riekszaminimi i dokumentacionit për transferimin e çmimit.

Dokumentacioni i përmirësuar i transferimit të çmimit ndikon direkt në rritjen e cilësisë së informacionit në dispozicion të administratës tatimore që e përdor atë. Raporti i masës 13 përmban një qasje të standardizuar me tre nivele ndaj dokumentacionit të transferimit të çmimit, duke përfshirë një raportim vend pas vendi (CBC – *country by country*). Ky standard pasqyron angazhimin për të implementuar projektin e këtij raportimi në mënyrë sa më të qartë. Si fillim, komentari mbi dokumentimin e transferimit të çmimit kërkon që kompanitë shumëkombëshe të japin informacion për transaksionet e tyre në lidhje me transferimin e çmimit dhe këtë informacion ta ruajnë në një dosje kryesore, të aksesueshme nga të gjitha administratat tatimore që e përdorin atë. Së dyti, detajet e transaksioneve të transferimit të çmimit të jenë në një dosje lokale ose dytësore

dhe të përshtatur për çdo vend që e përdor, duke treguar vetëm ato transaksione që cilësohen materiale, vlerën e tyre, dhe analizën e transferimit të çmimit të bërë nga shoqëria që ka përdorur këto transaksione. Së treti, çdo shoqëri shumëkombëshe do të ndërtojë një raport CBC i cili njëherë në vit do të njoftojë administratat tatimore ku bëhet biznes në lidhje me shumën e të ardhurave, fitimit para tatimit dhe tatimit të paguar, si dhe tregues të tjerë ekonomikë. Ky raport ruhet në vendin ku është selia qendrore e shoqërisë shumëkombëshe dhe shpërndahet automatikisht me shkëmbim informacioni. Të mara së bashku, këto tre nivele dokumentimi detyrojnë tatimpaguesit të tregojnë kujdes me transferimin e çmimit, dhe të ndihmojnë administratat tatimore me informacion të nevojshëm në vlerësimin e riskut të transferimit të çmimit.

Masa 14 – Rritja e efektivitetit të mekanizmit të zgjidhjes së konflikteve.

Shumë vende janë të bindura që ndryshimet nga projekti BEPS mund të sjellin raste të tatimit të dyfishtë dhe të hapin çështje të mirëkuptimit reciprok në një periudhë afatshkurtër. Duke patur parasysh rëndësinë që ka taksimi i dyfishtë në tregjet ndërkombëtare, vendet janë angazhuar për ndërtimin e një standardi minimal për rastet e konflikteve që mund të lindin, në veçanti, një angazhim politik efektiv dhe në kohë nëpërmjet procedurës së mirëkuptimit reciprok. Angazhimi përfshin edhe ndërtimin e një mekanizmi efektiv monitorimi për të siguruar që standardi minimal është arritur dhe vendet janë të gatshme të japin zgjidhje për problemet që lindin menjëherë.

Masa 15 – Zhvillimi i një instrumenti shumëpalësh (Konventa Shumëpalëshe-MLI).

Ky raport shikon mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje shumëpalëshe të përbashkët, që bën të mundur përfshirjen e masave BEPS në këtë marrëveshje, si dhe amendimin e marrëveshjeve dypalëshe të taksimit të dyfishtë pa qenë nevoja e amendimit të tyre një nga një me secilin shtet kontraktues. Aktualisht, deri tani 83 shtete kanë nënshkruar këtë instrument shumëpalësh.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij projektligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj parashikon shpenzime buxhetore pasi pjesëmarrja në kuadrin gjithëpërfshirës të BEPS-së kërkon pagesën e një tarife vjetore prej 20 200 eurosh.

KËSHILLI I MINISTRAVE